



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the General Secretary

Nr. 11 /2023
Datë: 31/01 /2023

Në mbështetje të nenit 18 të Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 7/01 Mars 2019), duke u bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe nenin 12 të Rregullores MF 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve, Zv. Sekretarja e Përgjithshme, nxjerr:

V E N D I M

Thirrje publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

1. Autorizohet shpallja e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.
2. Thirrja publike nga pika 1 e këtij vendimi bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores MF 04/2017, dispozitat mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, kodi ekonomik 21200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfereve në kuadër të nën programit buxhetor 01500.
4. Mjetet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve dhe dokumentacionit përkatës për zbatimin e thirrjes.
5. Dokumentacioni përkatës i nevojshëm dhe kriteret për aplikim për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, do të publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë (<https://md.rks-gov.net>).

6. Në përputhje me Rregulloren e MF 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, Ministria e Drejtësisë do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

7. Komisioni Vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses apo jo kushtet për të qenë pjesë e konkurrimit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

8. Anëtarëve të Komisionit Vlerësues u takon kompensimi për punën e kryer në komision sipas legjislacionit përkatës për punë jashtë orarit.

9. Zyrtari Kryesor Administrativ merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve të OJQ-ve pas pranimit të vendimit të Komisionit Vlerësues për aplikuesit e suksesshëm.

10. Ministria e Drejtësisë do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave dhe do të bëjë transferin e mjeteve financiare tek përfituesit, përkatësisht OJQ-të.

11. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është njësia përkatëse që mbulon fushat në bazë të thirrjes publike të shpallur nga Ministria e Drejtësisë.

12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Divizionit për Shërbimeve Sociale;*
- *Divizionit për Buxhetit dhe Financa;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*